

webermur stuko

Stuko patinimi

■ Përshkrimi

webermur stuko është një material për patinim me granulim shumë të imët.

■ Avantazhet

- Përgatitet dhe aplikohet lehtësisht
- Ekstremisht i bardhë
- I përshtatshëm vetëm për përdorim të brendshëm

■ Përdorimi

webermur stuko përdoret për lëmimin e mureve dhe tavaneve, në ambiente të brendshme, të thata dhe pa lagështirë. I përshtatshëm për përdorim në bazamentet më të lëmuara si betoni, fino dhe shumë i përshtatshëm për pllakat e gipsit. Rezultati përfundimtar i murit dhe i tavanit do të jetë ekstremisht i bardhë dhe i lëmuar.

■ Përgatitja e bazamentit

Temperatura e ajrit dhe bazamentit gjatë aplikimit dhe tharjes duhet të jetë mbi 5°C dhe nën 30°C. Bazamenti ku do të aplikohet stuko, duhet të jetë i fortë, i niveluar, i thatë dhe i pastër. Në rast të bazamenteve të vjetra është e këshillueshme që sipërfaqja të paratrajtohet me astarin / bazën e përshtatshme.

■ Udhëzime mbi aplikimin

Përzjerja e produktit duhet të bëhet në një enë të pastër. Përmbajtjes së thesit prej 15kg është e nevojshme t'i shtohet 6.5-7 litra ujë, duke e përzjerë me përzjerës elektrik, me numër të ulët xhirosh derisa të përfitohet një masë homogjene, pa kokrriza.

Koha optimale e përzjerjes nuk duhet t'i kalojë 3 minutat. Masa e përgatitur duhet të aplikohet brenda 1 ore, me anë të mallës metalike në një ose dy shtresa me trashësi maksimale 1,5 - 2 mm secila. Këshillohet që për aplikimin e shtresës së dytë, të pritët që shtresa e parë të ketë arritur tharjen e nevojshme dhe për të krijuar fortësinë optimale për shtresën e dytë.

Pasi është arritur tharja totale e materialit – pas 24 orësh pas mbarimit të shtresës së dytë, nëse është e nevojshme mund të fërkohet sipërfaqja ku është aplikuar materiali me letër zmerile të imët, për t'i dhënë asaj një pamje më uniforme dhe të lëmuar.

■ Konsumi

1 kg/m2 me dy shtresa

■ Paketimi

15 kg / thes
1200 kg / paletë

■ Ngjyra

E bardhë

■ Veglat

Për miksim: mikser elektrik
Për aplikim: mallë metalike

■ Jetëgjatësia

12 muaj, i magazinuar mbi paletë në zona të thata dhe pa ndikim të drejtpërdrejtë nga kushtet e motit. Duhet mbrojtur nga lagështira!

**Shënim: Të gjitha këto parametra janë të lidhura me kushtet standarde të motit, temperaturës 20°C dhe lagështisë relative deri në 65%. Në qoftë se kushtet e motit nuk janë në përputhje me procedurën e mësipërme është e nevojshme që të punohet për të përshtatur rrethanat. Weber garanton se cilësia e produkteve të dorëzuar përputhet me të gjitha normat dhe rregullat e prodhimit. Kompania nuk është përgjegjëse për gabime në aplikimin e këtij materiali, për përdorimin e materialit për qëllime jo të rekomanduara në përshkrimin e produktit, si dhe për aplikimin në kushte të tilla atmosferike që nuk janë në përputhje me specifikat në përshkrimin e produktit. Weber rekomandon që përpara fillimit të punës, të bëhet një test sipërfaqeje. Kompania pranon ankesa vetëm në cilësinë e produktit që mund të ketë qenë ruajtur, përgatitur dhe aplikuar sipas udhëzimeve të lëshuara. Informacioni i përfshirë në këtë fletë është rezultat i njohurive të disponueshme në datën e publikimit. Saint-Gobain Construction Products Albania nuk merr përgjegjësi për dëmtimin e personave ose të pronës që rezultojnë nga përdorimi i parregullt i këtij informacioni dhe rezervon të drejtën për të ndryshuar të dhënat pa paralajmërim.*



SAINT-GOBAIN CONSTRUCTION PRODUCTS ALBANIA sh.p.k

Rr. Budull, Nr.3 • 1039 Ahmetaq

Vore • Shqiperi

www.saint-gobain.com

NIPT : L61822023H

webermur stuko